

VENDIM
Nr.2, datë 9.1.2010

**PËR KRIJIMIN DHE MËNYRËN E PËRDORIMIT TË FONDIT TË
EMERGJENCAVE CIVILE NË QARKUN E SHKODRËS, PËR TË
PËRBALLUAR SITUATËN E SHKAKTUAR NGA PËRMBYTJET NATYRORE**
(Ndryshuar me VKM nr. 564, datë 14.7.2010; nr. 970, datë 1.12.2010)
(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5,7 e 32 të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshlli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e fondit për emergjencat civile në qarkun e Shkodrës, ku do të përfshihen:

- a) *Shuma prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh nga fondi rezervë i buxhetit;*
- b) Donacionet monetare të mbledhura në llogaritë bankare, të çelura për këtë qëllim;
- c) Fondet e miratuara për vitin 2010 për Ministrinë e Brendshme, në programin “Emergjencat civile”;
- ç) Ndihamat materiale në natyrë nga donacionet.

2. Këto fonde përdoren vetëm me vendim të Komitetit Ndërmintor për Emergjencat Civile dhe pagesat autorizohen nga prefekti i qarkut të Shkodrës.

3. Marrja në dorëzim e ndihmave materiale në natyrë bëhet nga Drejtoria e Emergjencave Civile, në Ministrinë e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit dhe degët rajonale, në varësi të saj.

4. Të gjitha ministratë, në bashkëpunim me kryetarët e njësive të qeverisjes vendore, kryejnë procedurat (vlerësim, blerje, marrje në dorëzim etj.), për shpenzimet e kryera në sektorët që ato mbulojnë në kuadrin e marrjes së masave të emergjencës. Të gjitha këto shpenzime do të njihen si të tilla, vetëm pasi të vërtetohen nga prefekti i qarkut të Shkodrës.

5. Shpërndajra e ndihmave në natyrë sipas vendimeve të Komitetit Ndërmintor të Emergjencave Civile, bëhet dhe dokumentohet nga drejtoritë rajonale në varësi të ministrive të linjës apo, në mungesë të tyre, nga vetë ministratë dhe kryetarët e njësive të qeverisjes vendore, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr.8756, datë 26.3.2001 dhe vendimit të Këshillit të Ministrave, dalë për këtë qëllim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha